

**DIRECTIVE SASO / ACCORD
N°1 – 2016**

**DIREKTIVË DETYRIMI PËR INFORMIM
NË RAST NDRYSHIMI TË RRETHANAVE**

Sipas nenit 17, paragrafëve 2 dhe 3 të rregullores për zbatimin e ligjit mbi harmonizimin dhe koordinimin e ndihmave sociale (RELHaCoPS) të 18 dhjetorit 2013,

Personi që kërkon ndihma duhet të njoftojë **menjëherë** në GSR **cdo ndryshim** të situates personale apo materiale, si dhe atë të të gjithë anëtarëve të familjes (referenca mbi njësinë ekonomike - UER), në Zvicër ashtu si edhe jashtë saj. Ndryshimet mund të kenë të bëjnë me gjendjen civile, me numrin e personave që jetojnë nën të njëjtën çati, me banesën, me të ardhurat dhe pasurinë, ashtu si edhe me formimin profesional.

Të njëjtit angazhim i nënshtrohen po ashtu edhe bashkëshorti, partneri, personi me të cilin bashkëjeton, kujdestari apo përfaqësuesi që ka prokurë të njëjtë me atë të prindërve, nëse personi në fjalë është në moshë madhore duke kryer studimet.

Është e mundur që këto ndryshime të çojnë në një reduktim, në heqjen e plotë apo në ndryshimin e së drejtës për përfitime sociale sipas LHaCoPS.

PASOJAT NËSE DETYRIMI PËR INFORMIM NUK RESPEKTOHET

Në qoftë se njoftimi i një ndryshimi nuk bëhet menjëherë, ai mund të shkaktojë një vonesë në pagesën e ndihmave ose në të kundërtën, një kërkesë për kthimin e parave të pajustificuara. Mosrespektimi mund t'ju çojë deri në ndjekje penale.

Në veçanti, duhen njoftuar ndryshimet e mëposhtme :

1. Strehimi :

- a. Ndryshimi i adresës ose ndërrimi i banesës në një komunë tjetër, në një kanton tjetër ose jashtë vëndit;
- b. Qiraja : rritja ose ulja e saj;
- c. Strehimi i përbashkët, ndarja e banesës me dikë tjetër : ndryshimi i numrit të personave që jetojnë së bashku.

2. Situata personale :

- a. Gjëndja civile : martesë, ndarja, divorci, vdekja e bashkëshortit ose e partnerit;
- b. Bashkëjetesa : fillimi ose fundi i bashkëjetesës, vdekja e personit me të cilin bashkëjeton;
- c. Familja : lindja, adoptimi ose vdekja e një fëmije.

3. Shkollimi : fillimi, fundi ose ndërprerja e një formacioni (studime, mësim...).

4. Të ardhurat e punës (duke përfshirë edhe vetëpunësimin, të ardhurat e rastit dhe mësimin) : rifillimin e një aktiviteti fitimprurës, të një biznesi të ri fitimprurës, rritjen ose uljen e pagës, ndërprerjen e punësimit fitimprurës.

5. Të ardhura të tjera : rritje, ulje ose ndërprerje (duke përfshirë edhe interesin mbi kapitalin).

6. **Pasuria :**
 - a. Pasuri të tundshme në Zvicër ose jashtë saj : trashëgimi, dhurim, pagesë e një sigurimi jetese ose e një kapitali për pension, fitim llotarie, rritje ose ulje tjetër e pasurisë ;
 - b. Prona të patundshme në Zvicër ose jashtë saj : blerje ose shitje shtëpish, ndërtesash ose tokash, trashëgimi, dhurim, rritje ose ulje tjetër e pasurisë.
7. **Shpenzimet për mirëmbajtjen e familjes** (pension mirëmbajtje) : nisja e së drejtës, rritja, ulja, ndërprerja, vendimi i ri gjyqësor, baza e re ligjore, etj.
8. **Ndihmat ditore** të AI, të sigurimit shëndetësor, të sigurimit të aksidenteve, të sigurimit të humbjes së të ardhurave (APG) ose të sigurimit të papunësisë :
 - a. Paraqitja e një kërke;e;
 - b. Fillimi i pagesës;
 - c. Rritja, ulja, ndërprerja.
9. **Të gjitha përfitimet e sigurimeve sociale ose private** : AI, aksidentet, shërbimi ushtarak, fondi i pensionit, papunësia, AVS, PC (shpërblime të tjera plotësuese AVS/AI), pensioni jashtë vëndit :
 - a. Paraqitja e një kërke;e;
 - b. Nisja e së drejtës, rritja, ulja, ndërprerja;
 - c. Pagesë retroaktive e përfitimeve të sigurimeve sociale ose private.
10. **Institucioni** (shkollë ose qëndër e specializuar, azil ose diçka tjetër) : hyrja ose dalja, ndryshimi i institucionit.
11. **Kujdestaria** : nisja ose përfundimi i një kujdestarie, ndryshimi i kujdestarit.
12. **Qëndrimi jashtë shtetit** që e tejkalon periudhën tre mujore të njërit prej personave të përfshirë në familje (UER).
13. **Çdo lloj ndryshimi tjetër** që ka të bëjë me të ardhurat, shpenzimet ose pasurinë.

Neuchâtel, Shërbimi i aksionit social, 8 janar 2016

PROCEDURA SIPAS SPORTELEVE SOCIALE RAJONALE –
SHËNIM I RËNDËSISHËM PËR PARAQITJEN E NJË KËRKESË PËR NDIHMA
SOCIALE (DPS)

FIRMAT DHE ANGAZHIMET QË KANË TË BËJNË ME NJË KËRKESË PËR
NDIHMA SOCIALE (DPS) (CF. FAQJA 2 FORMULARI 1ADMIN)

Duke nënshkruar, të gjithë antarët e familjes (UER) vërtetojnë se kanë plotësuar « Kërkesën për ndihma sociale » në mënyrë të plotë dhe në përputhje me të vërtetën, ashtu si edhe angazhimin e tyre për ta furnizuar autoritetin kompetent me të gjitha dokumentet e nevojshme që kanë të bëjnë me justifikimin e kësaj kërkeje për ndihma sociale. Ata angazhohen t'i komunikojnë **menjëherë** autoritetit kompetent **të gjitha ndryshimet** e situates së tyre personale dhe materiale. Ndryshimet mund të kenë të bëjnë veçanërisht me gjëndjen civile, me numrin e personave që jetojnë nën të njëjtën çati, me banesën, me të ardhurat e me pasurinë ashtu si edhe me studimet. Antarët e familjes që paraqesin një Kërkesë për ndihma sociale, dëshmojnë se e kanë pranuar direktivën e detyrimit për të informuar në rast ndryshimi të rrethanave. Kërkesat e pa firmosura do të kthehen mbrapsht.